



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 17, pika 2, lidhur me piken 6 të Ligjit për Dhënien e Pronës së Paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim Nr.06/L-092, nenit 36, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 29.06.2022, merr këtë:

VENDIM

për formimin e Komisionit vlerësues dhe zbatimin e procedurave për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim

Neni 1

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për formimin e Komisioni për vlerësimin dhe zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, në shfrytëzim afatshkurtër të Komunës së Vitisë: Njësia Kadastrale me Nr.P-70101018-00211-2, vendi i quajtur "Visoça", me sipërfaqe prej 81412 m²; Njësia Kadastrale me Nr.P-70101018-00211-4, vendi i quajtur "Visoça", me sipërfaqe prej 206276 m²; Njësia Kadastrale me Nr.P-70101018-00098-0, vendi i quajtur "Golesh", me sipërfaqe prej 771703 m², në zonën kadastrale në Devajë, Komuna e Vitisë.

Komisioni propozohet prej 5 anëtarëve, dy nga ekzekutivi, dy kuvendi i komunës dhe një nga shoqëria civile, dhe atë:

- Kushtrim Imeri, anëtar i komisionit (përfaqësues i ekzekutivit të komunës);
- Kemajl Frangu, anëtare e komisionit (përfaqësuese e ekzekutivit të komunës);
- Zejnepe Osmani (përfaqësues i kuvendit të komunës, subjekti LDK);
- Durim Sylejmani (përfaqësues i kuvendit të komunës subjekti LVV);
- Melihate Osmani (përfaqësues i sektorit joqeveritar).

Neni 2

Me këtë vendim, detyrat e Komisionit nga neni 1 i këtij vendimi janë përcaktuar në Ligjin për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, i Kuvendit të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës me Nr.10, të datës 03.04.2019).

Komisioni vlerësues udhëheq me procedurat mbi dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim si: përgatit kriteret e ankandit, përcakton çmimin fillestar, vlerëson ofertat dhe ja propozon kuvendit ofertën më të favorshme. Njësitë përkatëse të Administratës së Komunës i ofrojnë përkrahje Komisionit vlerësues.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen kryetari i Komunës, Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi dhe Drejtoria për Shërbime Publike e Komunës së Vitisë.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8, lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për procedurat e hartimit dhe publikimit të akteve të komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit, drejtorive;
2. Anëtarëve të komisionit;
3. MAPL-së; dhe
4. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË

